



PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT EKZEKUTIV DHE KRYETARIT TË ICC ALBANIA (Mandati 2024-2027)

Kjo Procedurë përshkruan procesin e zgjedhjes së anëtarëve në Këshillin Ekzekutiv të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipëri ("ICC Albania") për mandatin 2024–2027. Kjo Procedurë është propozuar nga Sekretariati i ICC Albania dhe miratuar nga Këshilli Ekzekutiv.

Çdo kundërshtim ndaj kësaj procedure të propozuar duhet të dorëzohet me shkrim pranë Sekretariatit të ICC Albania deri më *9 shtator 2024*. Nëse deri në këtë datë nuk merren kundërshtime, procedura do të konsiderohet e pranuar. Procedura do të paraqitet zyrtarisht për miratim në fillim të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Kuorumi: 2/3 e të gjithë anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar¹

PROCEDURË E PËRGJITHSHME E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE DHE KRYETARIT TË KËSHILLIT EKZEKUTIV

1. Format e votimit

Anëtarët me të drejtë vote mund të japin votën e tyre duke marrë pjesë personalisht në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të ICC Albania në datën e caktuar në orën 16:00 dhe duke dorëzuar një fletëvotim.

2. Regjistri i Anëtarëve Votues

Sekretariati i ICC Albania do të krijojë një Regjistër të anëtarëve votues "Regjistri i Zgjedhësve", duke renditur të gjithë anëtarët votues me të drejtë vote.

Anëtarët e ICC Albania që kanë të drejtë vote do të përfshihen në Regjistrin e Zgjedhësve. Anëtarët mund të përfaqësohen nga përfaqësuesi ligjor Ekzekutiv ose një Përfaqësues i Lartë i Autorizuar përmes një letre zyrtare përfaqësimi.

3. Mbikëqyrja

Zgjedhjet do të mbikëqyren nga një noter dhe një komision zgjedhor i emëruar nga Sekretariati me miratim të Kryetarit. Komisioni Zgjedhor duhet të përbëhet nga përfaqësues

¹ [Statuti i ICC Albania](#): Kapitulli VI, Par. 6.2.2 VI).



të kompanive anëtare të ICC Albania, të cilët janë në gjendje të mirë dhe nuk kanë lidhje me asnjë nga kandidatët.

4. Dokumentacioni

Pas shpalljes së rezultateve të votimit për anëtarët e Këshillit Ekzekutiv dhe atë të Kryetarit, Komisioni Zgjedhor do t'ia kalojë fletëvotimet Sekretarit të Përgjithshëm ose një përfaqësuesi të caktuar të ICC Albania. Rezultatet e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv dhe Kryetarit, duke përfshirë numërimin përfundimtar të votave, do të dokumentohen dhe depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm. Dokumentacioni do të përfshijë detajet mbi emërimet, Regjistrin e Zgjedhësve, rezultatet e numërimit të votave të nënshkruara, fletët e votimit të hedhura dhe çdo procedurë të zbatuar për zgjidhjen e balatozhit.

5. Publikimi i rezultateve

Rezultatet e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv dhe Kryetarit do të publikohen në faqen e internetit të ICC Albania dhe në kanalet e tjera të komunikimit. Megjithatë, numri i votave për secilin kandidat nuk do të publikohet.

6. Data e hyrjes në fuqi

Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Ekzekutiv dhe Kryetarit do të marrin detyrat e tyre në datën e shpalljes së vendimit të Gjykatës për miratimin e Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të ICC Albania. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv dhe Kryetari do të shërbejnë deri në fund të mandatit të tyre siç përcaktohet në dokumentet drejtuese të organizatës.

PROCEDURA ZGJEDHORE PËR ANËTARËT E KËSHILLIT EKZEKUTIV

1. Mënyra e votimit

Zgjedhjet do të zhvillohen me votim të fshehtë.

Kjo metodë siguron konfidencialitetin dhe autonominë e vendimit të secilit Anëtar Votues.

2. Hedhja e votës

Çdo Anëtar me të drejtë vote do të marrë një fletë votimi në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të shpërndarë nga Komisioni Zgjedhor.

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv të ICC Albania do të njoftojë hapjen dhe mbylljen e procesit të votimit. Fletët e votimit duhet të depozitohen në një kuti votimi, për të cilën Komisioni

Zgjedhor do të sigurohet se është bosh përpara përdorimit. Kutia e votimit do të mbyllet gjatë procesit të votimit, dhe çelësi do të mbahet nga Noteri. Anëtarët e Komisionit Zgjedhor do të mbikëqyrin hedhjen e votave.

Përpara votimit, çdo Anëtar Votues duhet të paraqesë kartën e tij të identitetit dhe, nëse është e aplikueshme, një autorizim zyrtar të përfaqësimit dhe të regjistrojë emrin e tij në Regjistrin e Zgjedhësve.

Votat duhet të hidhen nga vetë Anëtari Votues ose Përfaqësuesi i tyre i autorizuar siç është shënuar në Regjistrin e Zgjedhësve.

Një Anëtar me të drejtë vote mund t'ia delegojë votën e tij Kryetarit ose një Anëtar tjetër Votues duke nënshkruar një deklaratë përfaqësuese në formatin e dhënë nga Sekretariati i ICC Albania. Kjo deklaratë përfaqësimi duhet të dërgohet në emailin e Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë se tre ditë pune përpara Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

3. Numërimi i votave

- i. Në përputhje me këtë Procedurë, noteri i ndihmuar nga Komisioni Zgjedhor, do të shqyrtojë çdo fletë votimi, do t'i largojë ato të pavlefshme, do të numërojë votat në fletëvotimet e vlefshme, do të verifikojë nëse është plotësuar kuorumi dhe do të shënojë votat për secilin kandidat.
- ii. Një fletë votimi do të konsiderohet e pavlefshme dhe do të refuzohet në rastet e mëposhtme:
 - a) fleta e votimit është grisur, përmban emra, shënime ose vërejtje të tjera të shkruara në të, ka vizatime në të ose është e prishur ndryshe, përveç rasteve kur nuk mund të ketë dyshim të arsyeshëm për votat e dhëna;
 - b) fleta e votimit përmban më shumë se pesë (5) vota;
- iii. Fletëvotimi që nuk përmban asnjë votë për asnjë kandidat do të numërohet si abstenim.
- iv. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me të drejtën e votimit të anëtarëve me të drejtë vote, e ndodhur para ose gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, do të zgjidhet nga Noteri dhe Komisioni Zgjedhor në vend, në përputhje me këtë Procedurë.
- v. Pas mbylljes së votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, Komiteti Zgjedhor mblidhet për numërimin e votave dhe përmbledhjen e rezultateve. Pesë kandidatët me numrin më të madh të votave do të zgjidhen në Këshillin Ekzekutiv të ICC Albania.

Rezultati përfundimtar do t'i raportohet Sekretarit të Përgjithshëm të ICC Albania.

4. Shpallja e Rezultateve

Rezultatet do t'i shpallen menjëherë anëtarëve të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë nëse është plotësuar kuorumi dhe, nëse po, emrat e kandidatëve të zgjedhur në Këshillin Ekzekutiv të ICC Albania, të renditur sipas votave të marra.

i. Balotazh

Nëse dy ose më shumë kandidatë marrin të njëjtin numër votash dhe ka barazi për vendin e pestë (ose një pozicion më të lartë në rast të barazimit në një renditje tjetër), Komisioni Zgjedhor do të kërkojë që anëtarët votues të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të hedhin vota shtesë në një balotazh ndërmjet kandidatëve të barabartë. Kandidati që merr më shumë vota në balotazh do të zgjidhet anëtar i Këshillit Ekzekutiv.

PROCEDURA ZGJEDHORE PËR KRYETARIN

1. Mundësia për t'u nominuar për Kryetar

i. Përshtatshmëria

Vetëm anëtarët e Këshillit Ekzekutiv të cilët janë zgjedhur në mënyrë të rregullt në zgjedhjet aktuale kanë të drejtë të konsiderohen për pozicionin e Kryetarit. Kryetari në largim nuk ka të drejtë të kandidojë për një mandat tjetër si Kryetar.

2. Koha

Zgjedhja e Kryetarit do të bëhet menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të Këshillit Ekzekutiv.

3. Procesi i emërimit

i. Emërimi

Në përfundim të shpalljes së rezultateve për anëtarët e Këshillit Ekzekutiv, Kryetari aktual ose një person i caktuar do të thërrasë për emërimë për pozicionin e Kryetarit të ardhshëm.

Anëtarët e Bordit mund të emërojnë veten ose anëtarë të tjerë të zgjedhur të Këshillit Ekzekutiv.

Emërimet duhet të mbështeten nga një anëtar tjetër i Bordit për t'u konsideruar të vlefshme.

ii. Pranimi

Çdo kandidat duhet të konfirmojë pranimin e emërimit.

Të emëruarit do t'u jepet mundësia t'i drejtohen shkurtimisht Asamblesë së Përgjithshme nëse dëshirojnë.

4. Procesi i votimit

i. Mënyra e votimit:

Zgjedhja e Kryetarit do të bëhet me votim të fshehtë nëse ka më shumë se një kandidat. Nëse emërohet vetëm një kandidat, anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme do të vendosin nëse do të procedojnë me një votim të fshehtë apo një proces zgjedhor publik.

ii. Votimi i Fshehtë

Anëtarët votues do të votojnë duke shënuar zgjedhjen e tyre në fletën e votimit dhe depozituar në një kuti votimi, për të cilën Komisioni Zgjedhor do të sigurohet se është bosh përpara përdorimit. Të njëjtat rregulla të ndjekura për votimin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv do të zbatohen edhe për zgjedhjen e Kryetarit.

5. Numërimi i votave

Komisioni Zgjedhor do të mbledhë dhe numërojë votat. Të njëjtat rregulla të ndjekura për numërimin e votave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv do të zbatohen edhe për zgjedhjen e Kryetarit.

6. Shpallja e rezultateve

Rezultati i zgjedhjes së kryetarit do të shpallet menjëherë pas numërimit të votave. Kandidati me shumicën e votave do të shpallet Kryetar.

i. Balotazh

Në rast të barazimit, do të bëhet një balotazh ndërmjet kandidatëve me vota të barabarta. Nëse ndodhin barazime të mëtejshme, mund të mbahen raunde të tjera votimi derisa të arrihet një vendim i shumicës.